



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

25.06.2012

Reagim ndaj shkrimit në gazetën “Kosova sot”

AKP-ja NUK I SHET PRONAT PRIVATE

Prishtinë - Agjencia Kosovare e Privatizimit, në gjithë historinë e saj ekzistuese nuk ka shitur asnjëherë prona private. Në këtë rast, ju sqarojmë se përgjegjësitë e AKP-së, janë privatizimi dhe likuidimi i ndërmarrjeve dhe asetëve shoqërore, përgjegjësi kjo që i është dhënë Agjencisë nga vet Kuvendi i Kosovës, në bazë Ligjit Nr. 04/L-034, mbi AKP-në. Në bazë të kësaj, AKP obligohet me zotësi të plotë juridike, për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj.

I vetmi organ që mund të ndalojë procesin e privatizimit është Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, si institucion me juridiksion të plotë mbi AKP-në.

Shkrimi në gazetën Kosova Sot, me datë 25 qershor 2012, me titull: AKP-ja shet pronat private – Pronarët i paralajmërojnë institucionet”, bie në kontradiktë nga titulli dhe sqarimet në fund.

AKP bazuar në dokumentacionin ligjor që ka për ndërmarrjen shoqërore (NSH) NBI Suhareka, ka inicuar privatizimin e pronave në fshatin Grejkovc, të cilat sipas po këtyre dokumenteve janë pjesë e kësaj ndërmarrje. Kjo ndërmarrje shoqërore është në Likuidim që nga 31 dhjetori i vitit 2010-të. Në bazë të certifikatave që posedon AKP, tokat në fjalë bien nën administrimin e Agjencisë dhe si të tilla do të vazhdohet me procedurën e shitjes, në valën e 16-të të shitjes përmes likuidimit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në rastet e reagimeve të këtilla dhe pretendimeve pronësore nga individë të caktuar, njofton edhe ofertuesit, por është e detyruar t'i shes ato, derisa ka në posedim certifikatat, që dëshmojnë pronësinë shoqërore.

Edhe njëherë e rithekojmë që i vetmi organ që mund të stopoj dhe anulojë procesin e privatizimit është Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, ku palët e pakënaqura mund të parashtrojnë ankesa, ndërsa vendimet e Dhomës së Posaçme janë obliguese për Agjencinë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, shpreh shqetësimin për keqinterpretimet e tilla, të cilat janë pre e mosinformimit të duhur dhe ndonjëherë edhe tendenca për largimin e investitorëve dhe blerësve potencial.

AKP, sqaron se është një ekip i tërë që punon në procesin e privatizimit dhe se asnjë pronë, nuk privatizohet pa informacionet e nevojshme dhe, i gjithë procesi inicohet konform ligjit në fuqi.

Për të gjitha nismat AKP ka ofruar dhe vazhdon të ofrojë informacionet e bollshme për gjithë palët e interesuara.

FUND

Rr. Ilir Konushevc No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org